

AMF përfshihet në “Programin Kombëtar të Praktikave të Punës”

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, viti 2019
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2019
- Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, viti 2019
- Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, viti 2019

Zhvillime të tjera

- AMF ndërton regjistrin elektronik online të dëmeve TPL në shërbim të transparencës me qytetarët
- AMF fillon anketimin për njohuritë financiare të publikut për tregjet financiare jobankare

Edukimi i Konsumatorit

- IAIS – zhvillimet kryesore gjatë 2019

Lajme Ndërkombëtare

- Greqi
- Kosovë
- Kroaci
- Mali i Zi
- Maqedoni e Veriut
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF përfshihet në “Programin Kombëtar të Praktikave të Punës”



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit, Z. Ervin Koçi dhe Zv/ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Znj. Lorena Haxhiu gjatë takimit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare përfshihet në “Programin Kombëtar të Praktikave të Punës”, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në funksion të aftësimit të studentëve dhe përgatitjes së tyre për tregun e punës.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare përfshihet në “Programin Kombëtar të Praktikave të Punës”, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në funksion të aftësimit të studentëve dhe përgatitjes së tyre për tregun e punës.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit, Z. Ervin Koçi zhvilloi më 29 janar një takim me Zv/ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Znj. Lorena Haxhiu për të diskutuar rreth programit dhe nismave të ndërmarra nga Autoriteti për këtë qëllim. Z. Koçi e informoi Zv/ministren Haxhiu në lidhje me rolin aktiv që Autoriteti ka luajtur vitet e fundit në funksion të rritjes së edukimit financiar të qytetarëve për tregjet financiare jobankare, me fokus të posaçëm studentët dhe përgatitjen e tyre nëpërmjet praktikave të punës.

Kjo është realizuar me prezencën e stafit të Autoritetit në universitete të ndryshme, publike ose private, duke prezantuar institucionin, tregjet nën mbikëqyrje, anketimeve me studentët për të matur njohuritë e tyre financiare, si edhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet. Studentët, sidomos ata të fakulteteve të ekonomisë dhe drejtësisë janë target i informimit, komunikimit dhe edukimit, si pjesë e strategjisë së Autoritetit miratuar për këtë qëllim.

Për herë të parë, në vitin 2019 Autoriteti u dha më shumë mundësi të rinjve për zhvillimin e praktikave të punës, duke mirëpritur pranë institucionit një numër prej 50 studentësh dhe pranë subjekteve nën mbikëqyrje koordinoi praktikat për rreth 100 studentë.

Autoriteti synon që edhe përgjatë vitit 2020 të mirëpresë një numër të njëjtë studentësh për praktikat e punës, në komunikim të ngushtë me universitetet për një përshtatje sa më të mirë të profileve të tyre mësimore.

Kjo iniciativë do të vijojë të jetë kontributi që AMF në bashkëpunim me subjektet nën mbikëqyrje jep për edukimin financiar të brezit të ri dhe aftësimin e tyre për tregun e punës, këtë vit për herë të parë edhe në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, viti 2019


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2019 kapën vlerën mbi 17,618 milionë lekë, ose 4.11% më shumë se në vitin 2018. Gjatë vitit 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,350,075 me një rritje 3.18% krahasuar me vitin 2018.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.73% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.90% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.37%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.30% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.70% të totalit të tregut.

Gjatë vitit 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,377 milionë lekë, ose 8.58% më pak se në vitin 2018.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2019 kapën vlerën mbi 17,618 milionë lekë, ose 4.11% më shumë se në vitin 2018. Gjatë vitit 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,350,075 me një rritje 3.18% krahasuar me vitin 2018.

Struktura e tregut të sigurimeve, viti 2019 (Në %)




Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2019

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2019 u dominua në masën 53,92% në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 46.08% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 87.42% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2019 flasin për një dominim të transaksioneve “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Blerje në tregun primar” përkatësisht me 42.69% dhe 38.56% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për vitin 2019 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.20% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Letra me vlerë të Qeverisë viti 2019 (Në %)



Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2019, ka pasur një rritje prej 458 milionë lekë ose 8.85% krahasuar me vitin 2018. Ndërkohë numri i transaksioneve është ulur në masën 16.55%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë vitit 2019, ka pasur ulje prej 735 milionë lekë ose 22.52% dhe gjithashtu, një ulje në numrin e transaksioneve në masën 9.29%, krahasuar me një vit më parë. Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 277 milionë lekë, krahasuar me vitin 2019.


Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për vitin 2019 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.20% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, viti 2019

Gjatë vitit 2019, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendim nr. 210, datë 22.11.2019 licenoi “Albsig Invest”sh.a. - shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe miratimin e “Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig”.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare për vitin 2019 tregon një total asetesh neto prej 2,904.07 milionë lekë (23.85 milionë euro) dhe me një rritje prej 614.97 milionë lekë (26.87%) krahasuar me vitin 2018. Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, për vitin 2019 është 28,273 anëtarë duke shënuar rritje prej 11.76% krahasuar me vitin 2018.

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në FP, viti 2019 (Në %)



Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, për vitin 2019 është 28,273 anëtarë duke shënuar rritje prej 11.76% krahasuar me vitin 2018.

Tregues të Fondeve të Pensioneve

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)
Periudha	31.12.'18	31.12.'19	31.12.'18-31.12.'19
Asetet neto të FP	2,289.10	2,904.07	26.87


Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas Fondeve të Pensioneve, viti 2019

Fond Pensioni	Numri i anëtarëve në FP	Asete Neto (mln. lekë)
SIGAL	8,084	1,326.66
RAIFFEISEN	3,052	751.44
CREDINS PENSION	17,137	825.97
TOTAL	24,407	2,904.07

Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, viti 2019

Gjatë vitit 2019, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre pesë fonde investimi. Fondi i investimeve “Raiffeisen Prestigj”, fondi i investimeve “Raiffeisen Invest Euro”, fondi i investimeve “Raiffeisen Vizion” të cilat administrohen nga shoqëria “Raiffeisen Invest”, fondi i investimeve “Credins Premium” nën administrimin e shoqërisë administruese “Credins Invest” dhe fondi “WVP Top Invest” e cila administrohet nga shoqëria “WVP Fund Management Tirana sh.a.”.

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve, viti 2019 (Në %)



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendim nr. 210, datë 22.11.2019 licençoi “Albsig Invest” sh.a - shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe me Vendim nr. 255, datë 30.12.2019 licençoi fondin e investimit “Albsig Standard”, i administruar nga shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “Albsig Invest” sh.a.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.12.2019, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 66.79 miliardë lekë me një rritje prej 0.70 miliardë lekë ose 1.06%, krahasuar me 31.12.2018. E shprehur në euro, totali i aseteve neto është 548 milionë Euro.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 66.82% të aseteve të fondeve, me një rritje prej 5.47% krahasuar me 31.12.2018. Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 31.12.2019 është 29,243 me një ulje prej 0.60% krahasuar me 31.12.2018.

Tregues të Fondeve të Investimeve, viti 2019

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)
	31.12.'18	31.12.'19	31.12.'18-31.12.'19
Asetet neto të FI	66,087	66,788	1.06

Asetet neto dhe numri i anëtarëve, viti 2019

Fond Investimi	Numri i anëtarëve në FI	Asete Neto (mln. lekë)
Raiffeisen PRESTIGJ	21,191	41,965
Raiffeisen VIZION	3,893	11,196
Raiffeisen EURO	3,092	9,717
Credins PREMIUM	936	3,790
WVP Top Invest	131	120
TOTAL	29,243	66,788

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.12.2019, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 66.79 miliardë lekë me një rritje prej 0.70 miliardë lekë ose 1.06%, krahasuar me 31.12.2018.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF ndërton regjistrin elektronik *online* të dëmeve TPL në shërbim të transparencës me qytetarët

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka ndërtuar regjistrin *online* të integruar për të gjitha dëmet e ndodhura për policat e sigurimeve motorike TPL. Ky regjistër *online* u mundëson qytetarëve një numër identifikimi unik, që ata të ndjekin procedurën e pagesës së dëmit të tyre.

—○○○—
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka ndërtuar regjistrin *online* të integruar për të gjitha dëmet e ndodhura për policat e sigurimeve motorike TPL. Ky regjistër *online* u mundëson qytetarëve një numër identifikimi unik, që ata të ndjekin procedurën e pagesës së dëmit të tyre.
—○○○—

Qytetarët e siguruar me policat e sigurimit motorik, në momentin e aksidentit të ndodhur, duhet të drejtohen pranë shoqërisë së sigurimit për të raportuar dëmin. Sistemi elektronik pranë AMF-së nxjerr automatikisht një kod me 21 karaktere, me numra dhe shkronja, që fillon me datën e raportimit të dëmit të ndodhur. Këtë numër unik qytetarët e marrin nga shoqëria e sigurimit, brenda ditës, kur raportojnë dëmin.

Me anë të kodit unik të dëmit, qytetari kontrollon statusin e dosjes për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, pra se në cilën etapë të pagesës së dëmit ndodhet shqyrtimi dhe çfarë dokumentacioni duhet plotësuar më tej. Ky regjistër *online* i integruar i AMF-së dhe shoqërive të sigurimit mundëson komunikimin *online* të qytetarëve, specifikisht për dëmet motorike, i shtohet Platformës *Online* të raportimit të ankesave të qytetarëve në AMF e cila është funksionale prej shkurtit 2019.

AMF po punon edhe për ndërtimin e një sistemi tjetër *online*, ku në bazë të numrit të shasisë do të bëhet listimi i dëmeve të mëparshme të automjetit. Kjo do të shërbejë që qytetarët të njohin historikun e mjetit motorik. Ky informacion mund të gjendet në faqen *online* të AMF-së <https://amf.gov.al/vmws.asp>. AMF realizon kështu objektivin e saj kryesor në mbrojtje të konsumatorit dhe investitorit.

AMF informon qytetarët që për problematikat e tyre, mund të kontaktojnë dhe depozitojnë ankesat e tyre pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Rr. "Dora D'istria" Nr. 10, Tiranë, email konsumatori@amf.gov.al ose edhe në faqen zyrtare të Autoritetit <https://amf.gov.al/ankesa.asp>

AMF fillon anketimin për njohuritë financiare të publikut për tregjet financiare jobankare



◊◊◊
Anketimi do të shërbejë si bazë për përditësimin e strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit dhe investitorit për tregjet nën mbikëqyrje dhe për përmbushjen e objektivit të AMF-së për mbrojtjen dhe edukimin financiar të publikut.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka filluar një anketim të gjerë të popullsisë në vend për njohuritë mbi tregjet financiare jobankare dhe menaxhimin e financave personale. Anketimi do të shërbejë si bazë për përditësimin e strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit dhe investitorit për tregjet nën mbikëqyrje dhe për përmbushjen e objektivit të AMF-së për mbrojtjen dhe edukimin financiar të publikut. Anketimi po zhvillohet në disa qytete të vendit duke përfshirë punonjës si të sektorit publik edhe privat, nga disa degë si në prodhim, shërbime, edukim, etj.

Anketimi synon të masë mundësinë për rritjen dhe zgjerimin e tregut të sigurimeve, të fondeve të pensioneve private, vullnetare dhe të fondeve të investimeve. Për tregun e sigurimeve, ndër pyetjet e ndryshme, do të merren ide edhe për shtrirjen dhe zgjerimin e produkteve të sigurimeve në vend, duke qenë se Shqipëria renditet ndër vendet me vlerën e sigurimeve më të vogël për frymë të popullsisë në vend.

Shtrirja e sigurimeve dhe depërtimi i produkteve të ndryshme të sigurimeve vullnetare është një tjetër e dhënë që synon të nxjerrë pyetësori. Për tregun e fondeve të investimeve dhe atë të pensioneve private, pyetësori do të marrë informacion mbi mundësinë e zgjerimit të pjesëmarrjes në këto tregje, dhe faktorët që ndikojnë mbi këtë zgjerim. Anketimi do të vlerësojë edhe mendësinë e grupeve të ndryshme të popullsisë për alternativat e investimit në këto fonde.

Anketimi është ndërtuar dhe informacioni do të përpunohet nga grupi i studentëve të ekselencës që janë duke punuar pranë Autoritetit për të çuar më tej projektin e rritjes së edukimit financiar në vend. Të dhënat e anketimit do të shërbejnë AMF-së për të përditësuar Strategjinë e saj të Zhvillimit si edhe për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Edukimin Financiar.

IAIS – zhvillimet kryesore gjatë 2019

Fjala e Jonathan Dixon, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), mbajtur në forumin aziatik të sigurimeve “*Fintech Developments: Disruption or Dividends?*” zhvilluar në Hong Kong, 10 dhjetor 2019.

(Pjesa e dytë dhe e fundit - marrë me shkurtime dhe redaktime)

FinTech – Çështjet, sfidat dhe mundësitë

Nuk ka dyshim se FinTech krijon mundësi të mëdha për të mirën dhe mirëqenien e shoqërisë, veçanërisht në botën në zhvillim. Kjo është një mundësi që ne, si një bashkësi globale e mbikëqyrësve të sigurimeve, jemi të prirur të përqafojmë, edhe sepse është detyrë e jonë të jemi pjesë e zgjidhjes për zhvillimin e qëndrueshëm. Duke vepruar kështu, ne e kuptojmë nevojën për të punuar në bashkëpunim me partnerë të tjerë, përfshirë industrinë e sigurimeve.

Në të gjithë botën, 1.7 miliardë të rritur u ofrohen pak shërbime financiare, të pamjaftueshme duke përfshirë edhe sigurimin. Në shumë nga vendet në zhvillim, FinTech po ndihmon bizneset e vogla, në mungesë të bankave për të marrë shërbime financiare.

Edhe në ekonomitë e përparuara, konsumatorët duhet të përfitojnë. Aktorët e rinj që hyjnë në treg, mund të ofrojnë shërbime inovative në mënyrë më efikase se më parë, për shkak të modeleve plotësisht të dixhitalizuara të biznesit dhe përdorimit të teknologjive të reja. Konkurrenca dhe llojshmëria e madhe e ofruesve mund të krijojë një sistem financiar më efikas dhe elastik. Shoqëritë e sigurimit ekzistuese po përshtaten me shpejtësi në mjedisin e ri me strategji të ndryshme, duke filluar nga partneriteti me firmat InsurTech deri tek inovacioni e brendshme.

Sigurimi është, në thelb të tij, një biznes i të dhënave. Prandaj, dixhitalizimi i modeleve të sigurimit ka potencialin për të dhënë dividendë të konsiderueshëm: të krijojë efikasitet në zinxhirin e vlerës së sigurimit, të mundësojë vlerësimin më të mirë të rreziqeve dhe inovacionin e produktit, dhe të çojë në rritjen e zgjedhjes së klientit dhe qasje më të madhe në shërbimet financiare.

Sidoqoftë, këto risi nuk janë pa rrezik. Ndërprerjet e modeleve tradicionale, të cilat ne po i ndeshim shpesh mund të sjellin pa dashje rezultate të dobëta për konsumatorët dhe mund ta ekspozojnë sektorin në një çënueshmëri të rritur siç janë ndërlidhja e rritur dhe rreziqet në internet.

—○○○—
Në shumë nga vendet në zhvillim, FinTech po ndihmon bizneset e vogla, në mungesë të bankave për të marrë shërbime financiare.

—○○○—



Duke iu përgjigjur këtyre zhvillimeve, qoftë si politikbërës, mbikëqyrës apo industri - të gjithë përballemi me të njëjtën pyetje, si të arrijmë ekuilibrin e duhur midis rrezikut dhe përfitimit – shkëputjes dhe dividendit - duke marrë parasysh shkallën dhe ritmin e inovacionit teknologjik?



Duke iu përgjigjur këtyre zhvillimeve, qoftë si politikbërës, mbikëqyrës apo industri - të gjithë përballemi me të njëjtën pyetje, si të arrijmë ekuilibrin e duhur midis rrezikut dhe përfitimit – shkëputjes dhe dividendit - duke marrë parasysh shkallën dhe ritmin e inovacionit teknologjik? IAIS po shqyrton mënyrën se si ti mbështesim më së miri anëtarët tanë të ndryshëm për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, përmes nismave dhe platformave të shumta. Dua të ndaj me ju një pasqyrë të shkurtër.

Së pari, kemi shfrytëzuar ekspertizën e FinTech nga e gjithë anëtarësia jonë duke krijuar një Forum virtual FinTech. Forumi është një platformë për ekspertë të mbikëqyrëseve të ndryshëm për të shkëmbyer përvoja praktike dhe njohuri mbi një sërë risish teknologjike që ndikojnë sektorin e sigurimeve. Të tilla mund të jenë përdorimi i të dhënave alternative, kontraktimi i zgjuar përmes teknologjive, sigurimi P2P dhe ndikimi i teknologjisë në mjetet dhe burimet e mbikëqyrjes.

Për të dhënë një shembull se si funksionon kjo në praktikë: Banka Qendrore Holandeze kohët e fundit ndau në Forum FinTech udhëzimet e tyre të botuara për përdorimin e përgjegjshëm të Inteligjencës Artificiale (AI). Anëtarët më pas ishin në gjendje të konsiderojnë zbatueshmërinë e këtyre udhëzimeve në një numër skenarësh praktikë, të tilla si përdorimi i inteligjencës artificiale për zbulimin e mashtrimit në proceset e trajtimit të kërkesave dhe çmimet më të mëdha për aftësinë e kufizuar dhe sigurimin shëndetësor.

Në vitin që vjen, Forumi do të shikojë më nga afër implikimet e mundshme të Inteligjencës Artificiale dhe Mësimin të Makinerisë lidhur me teknologji siç janë telematika, mbi punën e mbikëqyrësve të sigurimeve dhe Parimeve Bazë të Sigurimeve të IAIS. Forumi gjithashtu synon të arrijë tek një komunitet më i madh i ekspertëve për të ndihmuar anëtarët tanë të zgjerojnë aftësitë e tyre mbikëqyrëse dhe të ecin përkrah me zhvillimet e FinTech.

Së dyti, IAIS fton një numër të madh akademikësh nga sektori i teknologjisë, nga industria dhe shoqatat mbrojtëse të konsumatorëve përmes ngjarjeve me tematikë dixhitale. Konferenca jonë Vjetore në Abu Dhabi në 2019 u organizua rreth temës së “Mbikëqyrjes në një epokë dixhitale”. Në fillim të vitit, ne zhvilluam një workshop me Rrjetin e Inovacionit Financiar të FSB-së në Londër, për të eksploruar një varg zhvillimesh.

Së treti, grupet e punës të IAIS vazhdojnë të punojnë për ndërtimin e udhëzuesve për mbikëqyrjen mbi rreziqet, tendencat dhe mundësitë e paraqitura nga FinTech. Për shembull, Grupi i Punës për Sjelljen e Tregut të IAIS kohët e fundit publikoi një material, projekt-kërkim për përdorimin e analizave të të dhënave të mëdha në sigurime, me një fokus të veçantë në rreziqet dhe përfitimet e mundshme për klientët që lidhen me përdorimin në rritje të algoritmeve dhe analizave të përparuara të të dhënave nga siguresit.

Materiali i përgatitur, pranon që “big data analytics, BDA” mund të sjellë një numër përfitimesh si për siguresit dhe për klientët. Granulariteti i të dhënave nga burime të shumta mund të çojë në produkte sigurimi më të personalizuar dhe të përbalueshme, zgjedhje të shtuara dhe më efikase për klientët.

IAIS pranon që mbikëqyrësit e sigurimeve kanë një rol të rëndësishëm në përfshirjen e inovacionit teknologjik për përfitime më të mëdha shoqërore. Por nga ana tjetër nevojitet sigurim i kujdesshëm, i drejtë dhe i përgjegjshëm i teknologjisë në interes të mbajtësve të politikave.

Siguruesit gjithashtu mund të përfitojnë nga BDA¹ duke zgjeruar shtrirjen e tyre, duke siguruar çmime më të sakta dhe duke ulur marzhet e kostos së tyre për efikasitetin operacional, duke siguruar kursime dhe zbulim më të mirë të mashtrimeve.

Nga ana tjetër, materiali kërkimor paralajmëron se kompleksiteti dhe paqartësia e algoritmeve mund të kërkojnë nga mbikëqyrësit të sqarojnë pritjet e tyre në nivele të përshtatshme të transparencës dhe përgjegjshmërisë së siguruesit për rezultatet e klientit që vijnë nga vendime të bazuara në algoritëm. Në këtë drejtim, kemi parë disa zhvillime të dobishme nga anëtarët tanë. Përveç udhëzimeve Holandeze dhe përvojës nga Singaporit, për shembull, ligji francez për një Republikë Dixhitale të miratuar në vitin 2016 detyron zbulime të drejta, të qarta dhe transparente për klientët për vendimet kontraktuale bazuar në algoritme. Kohët e fundit, në vitin 2019, Komisioni Evropian publikoi Udhëzimet e tij të Etikës për Intelgjencën Artificiale të Besueshme dhe Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) ngriti një grup ekspertësh këshillues për etikën dixhitale në sigurime.

Për nevojën e udhëzuesve të mbikëqyrjes ne kemi parë disa çështje të përbashkëta që janë të rëndësishme për anëtarët tanë si në juridiksionet e zhvilluara ashtu edhe ato në zhvillim. Këto përfshijnë mbrojtjen e të dhënave dhe përdorimin e drejtë dhe etik të të dhënave, hyrjen e ofruesve të Cloud të palëve të treta dhe lojtarëve të tjerë jo-traditional siç janë kompanitë BigTech në sektorin e sigurimeve dhe sfidat e përballeshmërisë dhe përfshirjes. IAIS pranon që mbikëqyrësit e sigurimeve kanë një rol të rëndësishëm në përfshirjen e inovacionit teknologjik për përfitime më të mëdha shoqërore. Por nga ana tjetër nevojitet sigurim i kujdesshëm, i drejtë dhe i përgjegjshëm i teknologjisë në interes të mbajtësve të politikave. Për ta arritur këtë, do të jetë e rëndësishme që anëtarët tanë të forcojnë komunikimin me autoritetet e mbrojtjes së të dhënave dhe konkurrencës, shkencëtarët e të dhënave, avokatët e konsumatorit dhe ekspertët e industrisë për të formuar përgjigje kolektive dhe të koordinuara ndaj këtyre temave gjithëpërfshirëse.

Së fundmi, ne e kuptojmë rëndësinë e punës së përbashkët me kolegët në organizmat e tjerë që vendosin standarde si edhe Bordin e Stabilitetit Financiar (FSB). Risitë teknologjike nuk influencojnë vetëm tregun e sigurimeve. Ne do të punojmë për të eksploruar çështjet ndërsektoriale. IAIS ka kontribuar për pjesën e sigurimeve në publikimin më të fundit të FSB me temë "BigTech në financa: Zhvillimet e tregut dhe implikimet e mundshme të stabilitetit financiar" dhe "Vartësitë e palëve të treta në shërbimet Cloud: Konsiderata implikimet në stabilitetin financiar".

Në përmbyllje, unë do të doja të kthehem në një pyetje që i bëmë audiencës muajin e kaluar në Konferencën tonë Vjetore: "Si duhet t'u përgjigjen mbikëqyrësit në epokën dixhitale çështjeve të mbikëqyrjes?" Përgjigja numër një ishte ndërtimi i aftësive dhe kapaciteteve! Kjo është arsyeja pse IAIS vlerëson mësimet e rëndësishme nga anëtarët tanë dhe grupe e interesit.

¹Big data analytics, BDA është përdorimi i teknikave të përparuara analitike mbi të dhënat e mëdha dhe të shumëllojshme që përfshijnë të dhëna të strukturuar, gjysmë të strukturuar dhe të pa strukturuar, nga burime të ndryshme, dhe në madhësi të ndryshme nga terabajt në zettabajt.

Greqi

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Greqi e mbylli vitin 2019 me 4.07 miliardë euro prime të shkruara bruto, me një rritje prej 8.7% krahasuar me një vit më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës ishin 1.97 miliardë euro, me një rritje prej 17% krahasuar me një vit më parë. Ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës ishin 2.09 miliardë euro, me një rritje prej 2% krahasuar me një vit më parë.

Kosovë

www.xprimm.com

Banka Qendrore e Kosovës ka ndërhyrë për të përmirësuar parametrat financiarë të siguruesve, duke kufizuar komisionet dhe shpenzimet operative në një kufi maksimal prej 24% të primeve të shkruara bruto për sigurimet e Jo-Jetës. Në bazë të ndryshimeve të fundit ligjore, për të mbajtur poshtë kufirin 24% shpenzimet e tyre, siguruesit duhet të reduktojnë komisionet për brokerat, stafin e punësuar, shërbimet, reklamat, etj. Banka Qendrore e Kosovës ka kufizuar gjithashtu në masën maksimale prej 8% të primeve të shkruara bruto komisionin e brokerave për sigurimin MTPL.

Ndërkohë, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, tregu i sigurimeve në Kosovë e mbylli vitin 2019 me 101.5 milionë euro prime të shkruara bruto, me një rritje prej 8.5% krahasuar me një vit më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 98 milionë euro, me një rritje prej 8.3% krahasuar me një vit më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 3.5 milionë euro, me një rritje prej 16.6%.

Kroaci

www.xprimm.com

Në vitin 2019, tregu i sigurimeve me Kroaci realizoi 10.54 miliardë kune (HRK, monedha vendase) ose 1.42 miliardë euro prime të shkruara bruto, me një rritje prej 7% krahasuar me një vit më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës ishin 7.47 miliardë kune, me një rritje prej 11.26% krahasuar me vitin 2018. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës ishin 3.06 miliardë kune, me një rënie prej 2.14% krahasuar me një vit më parë.

Mali i Zi

www.xprimm.com

Në vitin 2019, tregu i sigurimeve në Malin e Zi realizoi 94.76 milionë euro prime të shkruara bruto, me një rritje prej 9% krahasuar me një vit më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës ishin 77.63 milionë euro. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës ishin 17.13 milionë euro.

Maqedoni e Veriut

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve për vitin 2019 në Maqedoninë e Veriut ishin 10.58 miliardë dinarë, (MKD, monedha vendase) ose 172 milionë euro, me një rritje prej 6.61% krahasuar me një vit më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 8.75 miliardë dinarë, me një rritje prej 5.99% krahasuar me një vit më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 1.83 miliardë dinarë, me një rritje prej 9.64% krahasuar me një vit më parë.

Turqi

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Shoqatës së Siguruesve në Turqi, tregu i sigurimeve në Turqi e mbylli vitin 2019 me 69.24 miliardë lira (TRY, monedha vendase) ose 10.37 miliardë euro prime të shkruara bruto. Sigurimi i Jo-Jetës realizoi 57.88 miliardë lira prime të shkruara bruto, me një rritje prej 21.26% krahasuar me një vit më parë. Sigurimi i Jetës realizoi 11.35 miliardë lira prime të shkruara bruto, me një rritje prej 64.14% krahasuar me një vit më parë.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al